

Shkëlqeje Dritën Tëndë!

Shkëlqeje Dritën quhet mesazhi sepse kur e mendon, gjithë historia e Lajmit të Mirë ka lidhje me dritën. Duke nisur që nga fillimi : Perëndia vetë, Ai është Dritë, natyra e Tij, lidhja që Ai i bën gjithmonë dritës me veten, janë gjëra që kanë të bëjnë me dritën, ndriçimin, shkëlqimin, rrezatimin.

Ja një super varg: **1 Gjonit 1:5** “*Dhe ky është mesazhi që dëgjuam nga ai dhe po jua shpallim juve: Perëndia është dritë dhe në Të nuk ka kurrfarë errësire.*”

Perëndia që është drita vetë, kur Ai filloi të krijonte universin, nuk e filloi krijimin me: “U bëftë deti i Durrësit apo mali i Dajtit apo me kafshën apo me yjet, por e filloi me dritën, ja ta lexojmë te **Zanafilla 1:3** “*Pastaj Perëndia tha: "U bëftë drita!". Dhe drita u bë.*”

U ndezë drita së pari, pastaj Perëndia ia filloi punës së krijimit të botës.

Pastaj Perëndia vazhdoi me krijimin e çdo gjëje derisa e përmbylli me krijimin e burrit dhe të gruas. Ata u krijuan të jetojnë në dritën e Perëndisë.

Por e dimë tragjedinë e madhe që ndodhi, njeriu mëkatoi, zgjodhi të mos i bindet Perëndisë.

U nda nga Perëndia, iu largua dritës dhe filloi të ecte në errësirë, errësirë shpirtërore për shkak të shkëputjes nga Perëndia.

Po dëgjoja për një studim interesant që është bërë në Gjermani i cili kishte për bazë të zbulonte si sillet njeriu kur është në errësirë të plotë. Pa parë detajet e studimit po mendoja, shiko se për çfarë i harxhon lekët qeveria gjermane, për të bërë studime të tilla. Iu kanë mbaruar hallet e mëdha më duket, e merret me këto gjëra. Por gjithësesi, studimi ka diçka shumë të veçantë.

Eksperimenti ishte i tillë; i futën njerëzit në një sallë të madhe, shumë të hapur dhe ishin në rresht nga një anë e murit dhe i fikën të gjitha dritat, që të bëhej totalisht errësirë.

Dhe iu kërkua njerëzve të shikonin në anën tjetër të sallës, të mundoheshin të ecnin në vijë të drejtë derisa të shkonin në anën tjetër të sallës. Dhe kishin një si çip me vete që të ndiqnin lëvizjet, trajektoren e çdo personi. Eksperimenti u bë me disa qindra njerëz. Kaq e thjeshtë ishte! Je në këtë anë të murit, fikën dritat, duhet të shkosh në anën tjetër të murit të sallës në një vijë sa më të drejtë.

Përfundimi i studimit ishte: Çdo njeri, edhe pse po përpiquej të ecte në vijë të drejtë, kur eci në errësirë kishte bërë rrathë, nuk kishte ecur dot në vijë të drejtë. Çdo person kishte bërë rrathë! M'u duk sikur po përshkruante gjithë historinë e njerëzimit ai eksperiment.

Pa dritën e Perëndisë në jetën tonë, ne ecim në formë rrethore, bëjmë të njëjtat gjëra, të njëjtat gabime, përsërisim veten gjithë kohës, pa dritën e Tij. Pretendojmë që kemi progres sepse janë krijuar mjete të reja, gjëra të reja.

“Ka dalë iphone 15, tani do bëj gjëra të reja, ka dalë një aplikacion i ri, tani do bëj namin, ka dal kjo dhe ajo, të shikosh ti se çfarë do bëj, çfarë do të ndodh tani.”

Po ndodhin shumë risi të reja në teknologji... Por nga ana morale dhe etike, njerëzimi po bën rrathë, po përsëriten të njëjtat gafa, të njëjtat gabime. Para 100 vjetësh kishte: luftë, padrejtësi, pushtime, abuzime, korrupsion. Sot në shek.XXI ka :luftë, padrejtësi, pushtime, abuzime, korrupsion.

Pa dritën e Perëndisë, njeriu vetëm sa bën rrathë.

Por sigurisht, fundin e dimë, Perëndia do të bëjë që historia të shkojë aty ku do Ai. Ama neve na është dhënë Skica/Projekt-Plani sesi ta sjellim dritën në këtë botë, në botën tonë, aty ku jemi secili prej nesh.

Gjithë profetët e Dhjatës së Vjetër, thonin që do të vijë një ditë, kur Drita e Perëndisë do të shkëlqejë në tokë përsëri.

Ja si thuhet te **Isaia 9:2** “*Populli që ecte në errësirë, pa një dritë të madhe; mbi ata, që banonin në vendin territ, shkëlqeu drita.*” Kjo ishte një nga profecitë e ardhjes së Jezusit. Krishti erdhi në këtë botë dhe tha: **Gjoni 8:12** *Jezusi tha: "Unë jam drita e botës; kush më ndjek nuk do të ecë në errësirë, por do të ketë dritën e jetës".*

Kush e mban mend çfarë thashë në fillim? Kur u ndez drita, Perëndia filloi të punonte. Drita u ndez përsëri në botë kur erdhi Jezusi, dhe Perëndia filloi të punonte në botën e Tij.

-Mëkatet u falën, të sëmurët u shëruan, të lënduarëve i'u mjekuan plagët, të vdekurit u ringjallën, të shtypurit u çliruan.

-U ndez drita e Perëndisë përsëri në botën e Tij.

Po kishte vetëm një problem të vogël, Jezusi ishte 100% Perëndi por ishte edhe 100% njeri. Ai kur erdhi ishte i kufizuar fizikisht dhe shërbeu vetëm në Izrael. Por Perëndia kishte një plan për gjithë botën: Jezus Krishti, mori dishepujt e Tij, çuna, njerëz të thjeshtë si ti dhe unë dhe iu drejtua atyre me këto fjalë: **Mateu 5:14** “*Ju jeni drita e botës...*”

Që ka kuptimin; pasi e ke marrë dritën, ke marrë faljen e Perëndisë, ti je mbajtësi dhe ndriçuesi i kësaj drite në botën tënde. Kudo që shkon, ndriçohet drita e Perëndisë; tek puna, shkolla, familja, kafja, kudo që je ti.

Sa herë që merr një iniciativë sado të vogël, për t'i treguar dikujt dashuri, Lajmin e Mirë, dëshminë tënde; lutesh për dikë apo i jep një Bibël dikujt, drita jote ndizet! Kur ndizet drita, Perëndia fillon të punojë aty!

Secili prej nesh është drita e botës. Ajo që duhet të bëjmë është ta ndezim dritën që Perëndia të punojë nëpërmjet nesh tek dikush! Neve na duket sikur bota nuk do t'ia dijë për Perëndinë. Unë mendoj ndryshe: Bota nuk po di se kë të pyesë! Te pyesë dikë pa u ndjerë i gjykuar ose pa u ndjerë i përbuzur.

Nuk më hiqet nga mendja një gjë që tha një studente këtu se shumica e klasës së saj, agjëronin në kohën e ramazanit por kur ishte e marta e mirë, shumica që agjëronin shkuan te Kisha e Lacit.

Njerëzit po kërkojnë por nuk po dinë se ku të kërkojnë, kështu që po kërkojnë Kuturu!

Perëndia e di, që ti je mbajtësi i dritës së Tij por dhe djalli e di dhe ai ka frikë nga drita jote se mos ti e ndez dhe i thua dikujt për dashurinë e Perëndisë, sepse kjo e dëmton mbretërinë e tij të errësirës.

Ai do të hedhë gënjeshtër në mendjen tënde duke të thënë, që ti s'je dhe aq i zoti për këtë gjë, kjo është punë e drejtuesëve të kishës, nuk është puna jote kjo. Kjo është punë për ata që e dinë Biblën përmendësh dhe që kanë vite në besim, nuk është për ty. Ti je i/e ndrojtur, nuk flet aq rrjedhshëm, nuk je aq i shoqërueshëm, nuk është për ty.

Ajo që dua të kujtoj është se Perëndia të ka dhënë çdo gjë që të duhet për të ndriçuar dritën tënde, për ta ndezur dritën tënde, në një formë unike që nuk e bën dot njeri përveç teje.

Për ta ilustruar që ti je unik dhe ta ndriçosh dritën unike do të përdor modelet e llampave që shikon në foto.

Fillojmë me të parën...

Dritë e qetë: <https://unsplash.com/photos/IoyRaYHbd98>

Kur e shikon këtë dritë të jep qetësi dhe ngrohtësi

Ndoshta kjo është drita jote, drita që do Perëndia të ndriçosh. Perëndia të përdor ty për të sjell

qetësi dhe ngrohtësi në një bisedë, kur je mes shokësh, miqsh.

Ti i thua botës, qeshu, jeta është e bukur edhe mes vështirësive, hapja zemren Perëndisë, Ai të do shumë Ti e ke atë dhuntinë, që kudo që je dhe në ambiente të zymëta, ti sjell ngrohtësi, sjell paqen e Perëndisë, i bën njerëzit ta duan jetën më shumë dhe ta shijojnë atë.

Ti, drita jote është shumë e nevojshme në familjen e Perëndisë, për ta kthyer kishën në një familje të ngrohtë dhe të dashur.

Një duartrokitje për ata që ndriçojnë dritën e tyre me butësi dhe ngrohtësi.

Drita tjetër...

Dritë furre: <https://flamingoappliance.com/oven-repair/how-to-replace-an-oven-light-8-steps/> Dritën e furrës ku pjek gjërat. Atë dritë nuk e shikon shpesh, të bën punë për të parë sa

është pjekur ushqimi, a është pjekur apo jo ajo që ke vënë në furrë dhe kaq.

Mund të ngjajë me dikë që është introvert, që rri vetëm më shumë. Ndoshta je ti, ti nuk e ndjen të nevojshme që të shikojnë apo të dëgjojnë të tjerët, nuk do që të jesh në qendër të vëmendjes. Je i/e kënaqur duke shërbyer, duke bërë gjëra në prapaskenë.

Ngaqë kjo dritë është e vogël, ndoshta ti mendon, por unë s'jam dhe aq i rëndësishëm në mbretërinë e Perëndisë.

Të të them diçka, që nuk e kanë dritat e tjera, kjo llampë, llampa e furrës, mund të durojë temperatura të larta, deri në 500 gradë dhe përsëri vazhdon të ndriçojë.

Dritat e tjera s'do e duronin këtë lloj presioni, por kjo dritë nuk tutet, nuk fiket pavarësisht presionit. Por ndriçon fort dhe nderon emrin e Zotit pavarësisht presioneve apo situatave të vështira.

Një duartrokitje për ata që ndriçojnë pavarësisht situatave që mund tu ndodhin.

Dritë kristal: <https://www.dzd.co.uk/christmas/lights/indoor-lights/led-crystal-light-bulb-shape/>

Ndoshta je dritë kristali, i krijuar nga Perëndia për të sjell ndikim në vende kyçe, ndoshta Perëndia të ka përgatitur aty ku je, në një vend kyç, në punë shteti, person kyç në një punë private. Një vend që kur flet, njerëzit duan ta dëgjojnë çfarë mendimi ke.

Për të ndikuar në forma që nuk e bën një person tjetër për të sjell emrin e Perëndisë në ca vende që nuk mundën të gjithë. Ndoshta prindërit e tu e dinin që në fillim, sepse ti shkëlqejë në shkollë dhe ishe kujdestari i klasës, presidenti i shkollës, team leader, person me ndikim. Na duhen sa më shumë drita të tilla, nëse je ti, ndriçojë dritën tënde, ndize dritën tënde që Perëndia të veprojë.

Një duartrokitje për ata që sjellin këtë lloj ndikimi.

Dritë party: <https://unsplash.com/photos/jXkeRL4k6-g>

Ndoshta ti je drita e festës dhe për ty lezeti i jetës është aty ku ka volum të lartë dhe energji gjithë kohës. Ti nuk ke ndryshk në asnjë cep të trupit, janë të lëvizshme çdo kockë e trupit tënd. Ti e di se ku janë festat, si bëhet një festë për së mbari, nëse do kishe një makine të preferuar, do ishte makina e fundit, por pa motor, që lëviz vetëm me volumin e bokseve. Dhe ty të zë gjumi po qe festimi i qetë ose në studim Bible.

Mund të ketë ndonjë rast, kur duhet ta kuptosh që jo çdo gjë në jetë është me vrap dhe volum të lartë. Por ama ti e çon dritën e Perëndisë në disa vende ku nuk e çojnë dot të gjithë.

Një duartrokitje për dritën që ndriçon në këtë formë.

A po të vjen në mendje një person i tillë apo je vetë kështu?

Elektrik dore: <https://unsplash.com/photos/ksCDERQJRhA>

Ose ndoshta ti je si kjo dritë, elektrik dore. E veçanta e kësaj drite është fakti që punon kudo, është me bateri, nuk ka nevojë të lidhet diku që të bëjë punën e vet.

Kjo është drita e misionit, dritë që shkon në vende të tjera, shkon kudo nëpër botë dhe predikon Lajmin e Mirë të Jezu Krishtit. Sjell ndikim për Perëndinë në forma të ndryshme duke luftuar për ata që s'kanë fuqi të luftojnë, të ngrejë zërin për ata që s'kanë zë.

Ti e ke këtë dëshirën për të udhëtuar, për të shkuar diku jashtë këtij vendi dhe për të ndriçuar aty. Për ty që je jashtë Shqipërisë, ne kemi nevojë për ty sot më shumë sesa kurrë që ta ndriçosh dritën e Perëndisë aty ku je, mes Shqiptarëve aty por jo vetëm.

Një duartrokitje për ata që ndriçojnë në këtë lloj forme.

Drite Projektori: <https://unsplash.com/photos/1vD6QxzNHdM>

Ndoshta ti je kjo drita e fortë, si projektor i fuqishëm, që flet fjalë profetike për kohërat e fundit. Që ngre zërin për gjëra që të tjerët s'po flasin. Dhe e thua troç, bam në fytyrë. Dhe drita që shkëlqen ti, disa herë është aq e fortë saqë bëhet edhe e parehatshme.

Kur ndizet kjo dritë, ti shikon pluhurin në dhomë, shikon grimca pluhuri që nuk i tregojnë një dritë tjetër. Vargjet e tua të preferuar janë nga Zbulesa dhe Ezekieli

Ti mund ta nuhasësh mëkatën 100 metra larg dhe nuk rri dot pa e thënë. Ti se ke qejf llampën që ndriçon në party. “*Jo jo, ajo llampë është mëkatë, është bërë njësh me botën ajo, e di unë.*”

Nëse ti je kjo dritë, duhet të qetësohesh pak dhe të jesh i hirshëm kur e thua të vërtetën, ta thuash me dashuri, mos e lërë pa thënë sepse ai/ajo je ti, por thuaje me dashuri.

Llampa të tilla na duhen në mbretërinë e Perëndisë sidomos në këto kohë.

Një duartrokitje për ata projektorët e Perëndisë.

Drite e errët: <https://analoguewonderland.co.uk/blogs/film-photography-blog/why-are-community-darkrooms-so-important-an-interview-with-saim>

Dritë që ndriçon në vende delikate, si në ato dhomat e errëta ku bëhen fotografitë, duhet një lloj drite aty që të mos e prishë filmin dhe nga fotografia që lahet aty dalin gjëra të bukura. Ndoshta je person që shikon tek të tjerët diçka ndryshe. Te dikush që asnjëri nuk shikon diçka të mirë. Ti shikon diçka të mirë, tek çdo person dhe i jep mundësinë të shkëlqejë ai/ajo. Situatat që të tjerët i shikojnë të pashpresa, ti shikon shpresë dhe jep mundësi të dyta, të treta. E e merr për dore atë person, që të njohë dashurinë e Perëndisë dhe planin që ka Perëndia për atë person. Me durim ti e ndihmon të gjejë vendin e tij dhe të ndriçojë edhe ai/ajo.

Miq, sidomos në ditë të tilla na duhet kjo dritë, na duhen shumë si këto drita, drita që i ri-fortësojnë ata që janë rrëzuar dhe janë dobësuar, që i ngrenë edhe një herë në këmbë.

Një duartrokitje për këto drita në mbretërinë e Perëndisë

Dritë e çuditshme: <https://unsplash.com/photos/DlicPZ9qHOs>

Je tip i çuditshëm dhe duket sikur nuk lidhesh dot me të tjerët. Ke një botë tënden dhe njerëzit s'po të kuptojnë. Njerëzit shkojnë në qendër tregtare, shikojnë kinema ndërsa ti kënaqesh duke parë gjëra që njerëzit i kanë lënë pas dore ose mendojnë se iu ka kaluar koha, dokumentarë dhe muzikë të rrallë. Për shkak se je ndryshe, mund të mendosh se Perëndia nuk mund të përdorë ty, nuk ka nevojë për mua, ka të tjerë plot.

Shiko, nëse ti ke zgjedhur Jezusin, ti mund ta ndriçosh dritën e Tij në vende dhe mënyra që nuk mund ta bëjë njeri. Është dikush që mund ta shoh dritën e Perëndisë vetëm nëpërmjet teje

dhe po nuk e ndriçove ti këtë dritë ai/ajo s'ka për ta parë dot.

Një duartrokitje për këto drita në mbretërinë e Perëndisë

Kur i shikon të gjitha këto Drita, është imazhi i familjes së Perëndisë. Nuk kemi pse jemi të gjithë njësoj, nuk mund të jemi të gjithë njësoj. Perëndia na ka dhënë dhunti të ndryshme, aftësi të ndryshme, personalitet të ndryshëm, pasione të ndryshme, përvoja jete të ndryshme. Por jemi një, një trup, një familje, një kishë.

Ruhuni që të mos nënvlerësoni njëri-tjetrin ose të mbivlerësoni veten tuaj, që të mos krijohet përçarje në trupin e Krishtit. Urtësia jonë si familje dallohet kur themi:

“Ne nuk jemi thirrur për t’u vënë në garë me njëri-tjetrin por për ta plotësuar njeri-tjetrin. Ku secili prej nesh ndriçon Dritën e Jezu Krishtit”.

Kjo është lutja ime, siç Perëndia vetë tha në fillim, *u bëftë drita*, ta thotë mbi gjithë Shqipërinë dhe Shqiptarinë, *“u bëftë dritë çdo zemër Shqiptari.”*

Nëse kjo është lutja jote gjithashtu, e di si do duket? Si kjo foto, me të gjitha dritat që janë të ndryshme, por janë të ndezuara të gjitha dhe po ndriçojmë bashkë. Ku secili shkëlqen sipas formës që i ka dhënë Perëndia. Kur i kujtojmë vetes *“Unë Jam Drita e Botës”*.

Dhe sa herë që marrë iniciativën për t’i folur dikujt, për ta ndikuar dikë për Krishtin, le të lëvizë Fryma e Perëndisë dhe të bëjë punën e Tij te zemra e personave që na sjell në kontakt Ai.

Le të lutemi!